



BIO

Aelita MANI është aktualisht Përgjegjëse e Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës pranë Universitetit "Barleti". Ajo ka përvoja të gjata pune si drejtuese, akademike, dhe konsulente në disa fusha biznesi: në menaxhim sipërmarrje, marketing, mikrofinancë, pronësi industriale. Dr. Aelita MANI ka më shumë se 15 vjet përvojë akademike si lektore dhe drejtuese pranë disa universiteteve si: Universiteti LUARASI, në cilësinë e Përgjegjëses së Departamentit të Administrim Biznesit dhe Departamentit Ekonomiks, anëtare e Bordit të Administrimit si dhe anëtare e Senatit Akademik; Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë dhe Universiteti i Tiranës (Fakulteti i Ekonomisë).

Ka marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, me botime në revista kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ajo ka punuar për institucione dhe projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, si: Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë (PMU-Programi PHARE), 14 vjet përvojë në Institucione Financiare Jo-Bankare si Shoqëria e Parë Financiare "FAF" sh.a. dhe Fondi i Financimit të Zonave Malore (FFZM) (Drejtuese Departamenti dhe Përgjegjëse e Sektorit Marketing dhe Kërkim), Bordi Mbikqyrës i Kompanive të Sigurimit të Shqipërisë (anëtare bordi) dhe prej vitit 2011 është anëtare e Institutit të Përfaqësuesve Profesional të Zyrës Europiane të Patentave me qendër Mynih, Gjermani.

Dr. Aelita MANI për më shumë se 20 vjet ka përvoja të sukseshme si konsulente në disa fusha biznesi. Ajo ka më shumë se 20 vjet përvojë në fushën e Marketingut dhe Hulumtimeve të Tregut Bankar dhe Mikrofinanciar, Marrëdhënie me Publikun dhe Organizimin e Fushatave Promocionale; më shumë se 19 vjet përvojë në fushën e Mjedisit (Vlerësime, Auditime dhe Monitorime Mjedisore); më shumë se 18 vjet përvojë në fushën e Menaxhimit dhe Ndërtimit të Sistemeve të Cilësisë sipas Standarteve Ndërkombëtare të Cilësisë (TQM & ISO); më shumë se 18 vjet përvojë në fushën Pronësisë Industriale, dhe më shumë se 10 vjet përvojë në fushën e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtëshme.

AELITA MANI DOKTOR I SHKENCAVE

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Përgjegjëse e Departamentit të
Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Menaxhim, Marketing, Mikrofinancë
- Pronësi Industriale, Mjedis
- Menaxhim i Sistemeve të Cilësisë

EMAIL

fin.dep@umb.edu.al